



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zygodhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Ibhorni Panel za žalbe i Predstavke

A nr.103/2011

Paneli Zygodhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuese (BIRN), paraqitur kundër Lutfi Spahiu kryesues i qendrës së votimit dhe Sami Rexha anëtarë i komisionit, në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 26.01.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuese (BIRN).

ARSYETIMI

Më datë 24.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga BIRN-i në të cilën theksohet se me 23.01.2011 në vendvotimin 1109b/02r në shkollën fillore “Andon Zako Çajupi” në Mitrovicë, kryesuesi kësaj qendre Lutfi Spahiu dhe një nga anëtarët e komisionit Sami Rexha e kanë lejuar një person, bashkëqytetar të tyre që të votoj pa identifikim përkatës – me akreditim nga KOZ-ja që nuk është një identifikim i duhur për tu lejuar që të votojë. Sipas parashtruesit të ankesës si dokumente të nevojshme për tu votuar janë: pasaporta, letërnjoftimi, dhe patentë shoferi, ndërsa në këtë rast asnjëra nga ato nuk është përdorur. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e gazetarit Shengjyl Osmani

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) *Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk e ka identifikuar se cili ka qenë ai person që është lejuar të votojë pa dokumente të identifikimi përkatëse, kurse pretendimet për të cilësuar këtë person vetëm si 'bashkëqytetar të tyre' për PZAP nuk janë të mjaftueshme. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 103/2010 më datën 26.01.2011.

